



VENDIMI I PRANUESHMËRISË DHE

VENDIMI DHE GJETJET

Data e miratimit: 11 dhjetor 2020

Lënda nr. 2016-24

Vesko Kandić

kundër

EULEX

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, i mbledhur më 11 dhjetor 2020, me pjesëmarrjen e anëtarëve si në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Asistuar nga
Z. Ronald HOOGHIEMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës për rastin e lartpërmendur, e paraqitur në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin e llogaridhënies së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregulloren e punës së Panelit, me ndryshimet e fundit më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike në pajtim me Rregullën 13(3) të Rregullores së punës së Panelit, vendosë si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 1 korrik 2016 si rasti nr. 2016-24. Më pastaj është regjistruar gabimisht prapë si rasti nr. 2016-31 më 22 shtator 2016. Ky është rasti i njëjtë andaj edhe do të trajtohet si i tillë.
2. Përmes një letre të datës 1 korrik 2016, Paneli i informoi Misionin se ky rast është regjistruar në Panel.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli i kërkoi ankuesit që të paraqesë informata shtesë rreth ankesave të tij. Ankuesi fillimisht u përgjigj se për këtë rast nuk kishte informata shtesë.

4. Më 19 shtator dhe 17 tetor 2017, Paneli i dërgoi edhe dy kërkesa të tjera ku kërkoi informata shtesë përmes përfaqësuesit për familjet serbe të Qendrën burimore për persona të zhdukur, një OJQ në Prishtinë.
5. Më 20 tetor 2017, Paneli mori përgjigje përmes Qendrës burimore për persona të zhdukur me informata shtesë rreth kësaj ankese.
6. Më 8 dhjetor 2017, Paneli përcolli një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve tek shefja e Misionit EULEX-i Kosovë, ku e ftoi atë që t'i paraqiste përgjigjet dhe vërejtjet me shkrim të saja rreth ankesave më së voni deri më datë 26 janar 2018.
7. Përmes një letre të datës 17 janar 2019, Misionit prapë iu kërkua që të jepte përgjigje ndaj pyetjeve deri më datë 16 shkurt 2019.
8. Më 31 janar 2019, ankuesit iu kërkua që ta plotësonte formularin e aplikacionit me nënshkrimin e tij dhe datën.
9. Më 7 shkurt 2019, ankuesi paraqiti nënshkrimin e tij dhe datën në formularin e aplikacionit.
10. Përmes një letre të datës 8 prill 2019, Paneli prapë i kërkoi shefes së Misionit që të paraqiste përgjigje ndaj pyetjeve sapo që të ishte e mundshme.
11. Më 20 qershor 2019, ankuesi u informua se Paneli ende ishte në proces të shqyrtimit të ankesës së tij.
12. Parashtrimet e shefes së Misionit u pranuan nga Paneli më 30 shtator 2020.
13. Më 23 tetor 2020, parashtrimet e shefes së Misionit u përcollën tek ankuesi, i cili u ftua që t'i parashtronte komentet e tij, nëse kishte, deri më 20 nëntor 2020.
14. Më 29 tetor 2020, Paneli pyeti Misionin përmes postës elektronike nëse ata kishin për të bërë parashtrime shtesë rreth meritës së rastit nëse ai do të shpallej i pranueshëm.
15. Më 29 tetor 2020, Misioni u përgjigj me postë elektronike se ai nuk dëshironte të jepte vërejte të tjera në lidhje me këtë ankesë.
16. Prej ankuesit nuk erdhën parashtrime të tjera.
17. Me qëllim të kompensimit të një kohe që ishte humbur mes viteve 2017 dhe 2020, dhe me qëllim të garantimit të shpejtësisë së procedurës, Paneli e informoi Misionin përmes një letre të datës 18 shtator 2020 se tani ai do të merrej në parim me pranueshmërinë dhe meritat e të gjitha rasteve me një vendim të vetëm dhe më nuk do të jepte zgjatje të tjera të kohës përveç nëse paraqiten rrethana të jashtëzakonshme.
18. Mbi këtë bazë, Paneli ka vendosur që ta trajtojë çështjen e pranueshmërisë dhe meritës në lidhje me rastin në fjalë me një vendim të vetëm.

II. FAKTET

19. Faktet e paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidhen si në vijim.
20. Më 13 qershor 1998, Čedo Kandić, xhaxhai i ankuesit, sipas raportimeve ishte marrë me dhunë nga shtëpia e tij në Kotorr, Komuna e Skenderajt, Kosovë.

21. Më 15 qershor 1998, Radoslav Kandić, vëlla i personit të zhdukur dhe babai i ankuesit, dha një deklaratë para policisë gjyqësore, Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë në Mitrovicë (Raporti nr. 16203/98, datë 16 shtator 1998).
22. Sipas asaj deklarate, Čedo Kandić ishte marrë nga 8 (tetë) persona të pidentifikuar të maskuar dhe me uniforma, dhe që kishin armë automatike. Ai ishte dërguar në një drejtim të panjohur.
23. Rasti ishte raportuar në polici, Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, dhe tek Qendra e së drejtës humanitare në Serbi.
24. Qysh atëherë nuk ka pasur asnjë gjurmë të Čedo Kandić.

III. ANKESA

25. Ankuesi i referohet dy të drejtave themelore të caktuara të pasqyruara në dispozitat si në vijim: neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) nën kreun procedural, që garanton të drejtën themelore të individit për jetë dhe parasheh detyrim për hetimin e rasteve të vdekjeve të dyshimta; dhe neni 3 i Konventës që garanton të drejtën e personit që të mos i nënshtrohet torturës apo trajtimin ose dënimin çnjerëzor apo degradues.

IV. QËNDRIMI

26. Misioni nuk merr qëndrim nëse ankuesi mund të konsiderohet viktimë për qëllimin e dhënies së qëndrimit për rastin në fjalë.
27. Duke u bazuar në këtë dhe duke pasur parasysh faktin se ankuesi është familjar i afërt i personit të zhdukur dhe duket të jetë përgjegjës në emër të familjes për përfaqësimin e interesave të tyre kolektive, Paneli është i bindur për përmbushjen e kushteve sipas rregullave 2(3) dhe 25(1) të Rregullores së punës së Panelit.

V. PARASHTRIMET E PALËVE

Parashtrimet e ankuesit

28. Siç shihet nga formulari i ankesës, ankuesi pretendon se, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i Kosovë do të duhet të hetonte zhdukjen e xhaxhait të tij dhe me faj nuk ka vepruar ashtu duke i shkelur ashtu të drejtat e tij themelore.

Parashtrimet e Shefes së Misionit

29. Përmes një letre të datës 24 shtator 2020, Shefja e Misionit u përgjigj në pyetjet e Panelit. Në pyetjen nëse dhe kur Misioni ishte vënë në dijeni rreth atij rasti, Misioni u përgjigj si në vijim. EULEX-i Kosovë thotë se për 'kidnapimin' e Čedo Kandić ishte vënë në dijeni pas dorëzimit të rasteve dhe dosjeve të rasteve nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) tek EULEX në periudhën dhjetor 2008 deri mars 2009. Si pjesë e atij procesi, Njësia e EULEX për hetimin e krimeve të luftës – NjHKL – mori në *'Raport hetimor Ante-Mortem'* nga UNMIK me datë 30 dhjetor 2004. Ai raport përmbante informatat nga burime të hapura të pidentifikuara rreth rrëmbimit të z. Kandić më 13 qershor 1998. Ky raport thuhet se përmban një nocion ku theksohet se

'asnjë dëshmitar nuk ka mundur të identifikohet, ose për shkak se ata nuk kanë qenë duke jetuar në Kosovë ose për shkak se lokacionet e tyre ishin të panjohura'.

Në raport gjithashtu sugjerohet se 'natyra kriminale e zhdukjes së Kandiçit ishte e qartë' dhe se rasti duhet të vazhdon të qëndrojë i hapur në Njësinë e UNMIK për krime të luftës.

30. Megjithatë, Misioni thekson, në kohën e dorëzimit në EULEX, baza e të dhënave e shtyllës së UNMIK për krimet (ku gjendeshin të gjitha dosjet e emërtuara 'krime të luftës') kishte indikuar se rasti i hapur rreth zhdukjes së z. Kandiç ishte 'mbyllur'.
31. Misioni po ashtu cekë se NjHKL në EULEX kishte kontaktuar me ankuesin në pranverë të vitit 2012 gjatë hetimeve të veprave që pretendohet se ishin kryer gjatë konfliktit. NjHKL 'mori nga ankuesi shënime që babai i tij z. Radoslav Kandić, i kishte shkruar pak pas rrëmbimit të vëllait të tij Čedo Kandić'.
32. Ndaj pyetjeve të Panelit se nëse rasti i ankuesit ishte transferuar në EULEX dhe se çfarë masash ishin marrë nga EULEX për regjistrimin, ruajtjen dhe kategorizimin e rasteve, Misioni shpjegoi *in extensu* procesin përmes së cilit ai i kishte pranuar, organizuar dhe regjistruar rastet nga UNMIK. Në atë mënyrë, ai kishte proceduar me mijëra dosje të rasteve individuale, përfshirë disa që i takonin 'personave të zhdukur'. Prej rreth 5000 dosjeve të rasteve 'të personave të zhdukur' të pranuar në EULEX, 'rreth 2000 ishin shënjuar nga UNMIK si 'aktive'/'joaktive' apo 'në pritje', dhe 3000 si 'të mbyllura'.' Rastet e 'mbyllura', Misioni thotë, 'ishin ato për të cilat mbetjet e personave të zhdukur ishin të gjetura në momentin e dorëzimit'. Të gjitha rastet e tjera ishin mbajtur të 'hapura' dhe/apo 'në pritje' nga policia e UNMIK, siç duket për shkak të mungesës së zhvillimeve apo informatave të reja.' Në përgjithësi, dosjet e rasteve të 'krimeve të luftës' dhe 'personave të zhdukur' të dorëzuara nga UNMIK tek EULEX- Kosovë janë përbërë prej rreth 800,000 faqe. Ai proces ishte i gjerë, i gjatë dhe i ndërlikuar. Misioni investoi shumë kohë – dhe, me supozim, shpenzime – për atë proces.
33. Përveç kësaj, UNMIK po ashtu dorëzoi edhe një numër të baza e të dhënave që përmbanin informata shtesë, përfshirë një për dosjet policore të 'krimeve të luftës' dhe një tjetër për rastet 'e personave të zhdukur'.
34. Në kohën e dorëzimit në EULEX, baza e të dhënave e 'personave të zhdukur' kishte një regjistrim për Čedo Kandić, por kutia e 'statusit' ishte e zbrazët. Regjistrim kishte edhe në databazën e 'krimeve të luftës', aty ishte i shënjuar si 'i mbyllur'.
35. Sa i përket kategorizimit të rasteve të pranuar prej UNMIK, Misioni shpjegon se kategorizimi i rasteve aktive dhe dosjeve të rasteve të pranuar prej UNMIK 'dukeshin menjëherë sfidë e madhe për EULEX'. Organizimi i UNMIK-ut ishte jo i plotë, kontradiktor dhe, në disa aspekte, jopraktik, ashtu që EULEX iu deshtë që të zhvillonte një proces të gjerë të shqyrtimit. Për këtë arsye, Misioni ka kryer disa shqyrtime të dosjeve përgjatë viteve.
36. Misioni po ashtu thekson këtë:

'Nga shqyrtimi i të dhënave të EULEX, del se kurdo të prokurorët e EULEX kanë hasur në dosje të rasteve që i përkasin veprave të pretenduara penale (përfshirë vrasje dhe kidnapime) që kanë ndodhur pas datës 21 qershor 1999, ata e kanë konsideruar veten jokompetent dhe rastet i kanë përcjellë tek prokuroritë përkatëse të qarkut. Rastet e hedhura poshtë apo të ndërprera nuk janë vlerësuar meqë ato ishin mbyllur për nga aspekti procedural. Rastet e personave të zhdukur, të 'hapura' apo 'të mbyllura' dhe dosjet e rasteve të krimeve të luftës 'të mbyllura' nuk janë vlerësuar nga PSRK në baza rutine.'

37. Bazuar në të dhënat e UNMIK, në lidhje me rastin aktual, Misioni thekson, për shembull, se –

‘rrëmbimi i Čedo Kandić është regjistruar me një numër të rastit të “personit të zhdukur”, si dhe me një numër të rastit të “krimit të luftës”, ku ky i fundit është hapur pas raportimit të rrëmbimit nga disa përfaqësues të fshatit [...]. [N]ë momentin e dorëzimit tek EULEX, rasti i Čedo Kandić është përfshirë në databazën e personave të zhdukur ku kutia e “statusit” ishte lënë e zbrazët, ndërsa në databazën e shtyllës penale ai është shënjuar si “i mbyllur”.

38. Ndaj pyetjes se çfarë hapash janë ndërmarrë nga Misioni për identifikimin dhe hetimin e rasteve të zhdukjeve të detyruara dhe vrasjes gjatë konfliktit apo menjëherë pas tij, Misioni sugjeron se nocioni i ‘zhdukjes së detyruar’ nuk ishte paraparë në mënyrë shprehimore nga korniza juridike relevante dhe sugjeron se ndonëse këto akte mund të përbëjnë krim kundër njerëzimit, ato mund të mos përbëjnë krim lufte.

39. Në lidhje me përfshirjen e Misionit në këtë rast, Misioni thekson se pavarësisht se rasti i z. Kandić është shënjuar si i ‘mbyllur’ në disa regjistra të UNMIK, PSRK ka përpiluar një raport me të dhëna të hollësishme rreth ‘gjendjes së dosjes’ ku ai ka thekuar se zhdukja e Čedo Kandić ishte raportuar nga përfaqësuesit serb të një fshati të caktuar, se ajo kishte ndodhur ‘para luftës’, se ky ishte rasti i personit të zhdukur dhe se autoritetet duhet t’i gjejnë dëshmitarët e mundshëm. Misioni gjithashtu shton si në vijim:

‘duket se asnjë veprim nuk është ndërmarrë në lidhje me këtë dosje të rastit deri në tetor 2013, kur Udhëheqësi i EULEX në PSRK e referoi rastin në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, me cilësimin hipotetik të “vrasjes së rëndë”. Është e qartë se arsyeja kryesore për referimin e kallëzimit penal të dorëzuar nga përfaqësuesit e përmendur të fshatit në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, ishte supozimi i rremë se kidnapimi ishte bërë jashtë kornizës kohore të konfliktit të armatosur, andaj PSRK nuk e kishte kompetencën ekskluzive për këtë rast.’

40. Misioni më tej shpjegon:

‘Pavarësisht prej të gjitha të lartcekurat dhe të palidhura me to, bazuar në informatat në dispozicion, Misioni mund të konfirmon se rrëmbimi i Čedo Kandić është hetuar nga njësitë e tij policore dhe prokuroriale, si pjesë e një hetimi më të madh të veprave penale të kryera gjatë konfliktit, të cilat kanë rezultuar me procedura penale të filluara nga Misioni kundër një numri individësh. Siç është në dijeni z. Kandić, NjHKL e EULEX ka qenë në kontakt me të në maj të vitit 2012 dhe më vonë ka intervistuar një numër individësh në lidhje me rrëmbimin e xhaxhait të tij. Megjithatë, Misioni supozon se hetimet për rrëmbimin e Čedo Kandić nuk kanë shkuar përpara nga mungesa e informatave të mëtejme.

41. Ai pastaj shton:

Në shënimin e dorëzimit nga EULEX dhe bashkëngjitur me dosjet përkatëse të rasteve që janë transferuar tek institucionet e Kosovës në shtator 2018, Misioni iu rekomandoi autoriteteve prokuroriale të Kosovës që të hapin një rast të ri në lidhje me zhdukjen e Čedo Kandić.

42. Ndaj pyetjes nëse EULEX është në dijeni nëse ky rast është duke u hetuar nga të tjerë, Misioni ‘fton ankuesin që të kontakton institucionet kompetente në PSRK dhe në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë’. Paneli e kupton këtë përgjigje se Misioni nuk është në dijeni për zhvillimin aktual të ndonjë hetimi të tillë. Misioni shton se:

‘qëndron i gatshëm që t’i ofrojë numrat përkatës të rastit për të ndihmuar kërkesën për informata nga ankuesi.’

43. Misioni nuk pati asgjë për të shtuar rreth pjesëmarrjes së të afërmeve të viktimës në hetime, e as nuk dëshiron të shtojë ndonjë gjë rreth pyetjes së Panelit se nëse dëshmitarët apo të dyshuarit e mundshëm janë marrë në pyetje. Paneli i kupton këto përgjigje si përveç kontaktit të Misionit me ankuesin, Misioni nuk ka bërë përpjekje të tjera për ta informuar, pyetur, apo kontaktuar familjen e viktimës në lidhje me këtë çështje.
44. Misioni po ashtu nuk i është përgjigjur pyetjes së Panelit në lidhje me dokumentet që Misioni i ka dhënë familjarëve të të zhdukurit. Paneli e kupton këtë se kjo gjë nuk ka ndodhur.
45. Ndaj pyetjes së Panelit nëse Misioni ka qenë në dijeni për ndonjë hetim në proces rreth këtij rasti, Misioni është përgjigjur se ai më nuk është kompetent për hetime dhe se ankuesi duhet të kërkojë informata prej autoriteteve të Kosovës. Paneli e sheh këtë përgjigje si indikacion se Misioni nuk ka informata për hetime aktuale rreth këtij rasti.
46. Në lidhje me pyetjen nëse Misioni konsideron se të drejtat themelore të ankuesit janë shkelur, Misioni thekson si në vijim. Së pari, ia le Panelit të vendosë nëse ankuesi ka qëndrim në këtë çështje nga fakti se ai është nipi i personit të zhdukur dhe ‘kërkuesi’ i tij.
47. Së dyti, Misioni shton këtë:

‘EULEX-i pranon se ankuesi dhe familjarët e Čedo Kandić kanë të drejtë të dine se cka ka ndodhur me të dhe të drejtë për hetime efektive. Megjithatë, ai konteston se Misioni mund të thuhet t’i ketë shkelur të drejtat e ankuesit sipas Konventës dhe rithekson atë që tashmë e ka thënë në lidhje me ankesat që ngritin pretendime të ngjashme. Një vlerësim i veprimeve të EULEX sipas kreut procedural të nenit 2 dhe nenit 3 të Konventës në lidhje me këtë rrëmbim specifik, nuk mund të e shpërfillë shkallën e sfidave me të cilat EULEX është dashur të përballë që nga fillimi i mandatit të tij.’

48. Misioni pastaj i drejtohet shkallës së sfidave për hetimin e këtij lloji të rasteve, kufizimit të burimeve me të cilin është përballur dhe sugjeron që pritjet duhet të jenë ‘reale’ dhe proporcionale. Misioni shton:

‘Misioni pranon se menaxhimi i dosjeve të trashëguara nga UNMIK ishte sfidë dhe se kishte qenë e pamundur të rregulloheshin shumë mospërputhshmëri dhe dyfishime. Ai gjithashtu pranon se njësitë e tij policore dhe prokuroriale do të duhej të kishin siguruar një komunikim më të mirë me viktimat dhe familjarët e viktimave, si dhe me publikun e gjerë. Megjithatë, ai pohon se do të kishte qenë thjeshtë joproporcionale të pritej se Misioni do të mund t’i hetonte të gjitha vrasjet, vdekjet e dyshimta dhe zhdukjet njëkohësisht si dhe t’i informonte familjarët e të gjitha viktimave rreth statusit të hetimeve. Andaj, në rastin aktual dhe duke i konsideruar pengesat themelore të paraqitura, Misioni nuk beson se të drejtat e ankuesit janë shkelur.’

49. Misioni ka shtuar më tej:

‘EULEX-i dëshiron të rikujton se sipas mandatit aktual, Misioni ka kapacitete ekzekutive për mbështetjen e Institutit të Kosovës për Mjekësi Ligjore në kryerjen e një sërë aktiviteteve si vlerësime të lokacioneve, zhvarrime dhe gërmime. Nëse dalin informata të besueshme, Misioni është i gatshëm t’i mbështetë institucionet

e Kosovës në çfarëdo përpjekje për gjetjen e z. Čedo Kandić dhe personave të tjerë të zhdukur.’

VI. PRANUESHMËRIA

Mandati i Panelit (rregulli 25 par. 1 i Procedurës së punës) dhe kufizimet e qenësishme të vëna mbi Misionin rreth mbrojtjes së të drejtave të njeriut

50. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të aplikojë instrumentet e të drejtave të njeriut ashtu siç është e pasqyruar në Konceptin e llogaridhënies së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Për punën e Panelit instrumentet e rëndësishme të posaçme janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat i përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet juridike demokratike.
51. Para shqyrtimit të ankesës për sa i përket meritave, Paneli duhet të merr vendim rreth procedimit të ankesës, duke i pasur parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Rregullin 29 të Rregullores së punës.
52. Sipas Rregullit 25, paragrafi 1, Paneli mund t'i shqyrtojë vetëm ankesat për shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
53. Paneli tashmë ka vërtetuar se veprimet e prokurorëve dhe policëve të EULEX-it përbëjnë pjesë të mandatit ekzekutiv të EULEX-i Kosovë dhe kështu bien në kuadër të fushëveprimit të mandatit të Panelit (shih, për shembull, *K deri T kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, par. 43; *Krlić kundër EULEX-it*, 2012-21, 26 gusht 2014, par. 23; *Y kundër EULEX-it*, 2011-28, 15 nëntor 2012, par. 35). Ky po ashtu është rasti i detyrimeve pozitive apo mosveprimeve me faj.
54. Paneli tashmë ka pasur rastin të thekson se Misioni EULEX nuk është shtet dhe se mundësia e tij për garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet relevante me atë që do të mund të pritej prej ndonjë shteti (shih vendimin e Panelit për *A,B,C,D kundër EULEX-it*, 2012-09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, par. 50; *K deri T kundër EULEX-it*, cituar më lartë, par. 53; krahaso po ashtu vendimin e Panelit Këshillues të UNMIK për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) për rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 35).
55. Për vlerësimin e ankesës aktuale, Paneli po ashtu ka marrë parasysh vështirësitë që domosdoshmërisht kanë qenë pjesë e hetimeve të krimeve në një shoqëri të pas konfliktit si Kosova (shih *Palić v. Bosnja dhe Hercegovina*, kërkesa nr. 4704/04, Aktgjykimi i GjEDNj e datës 15 shkurt 2011, par. 70; vendimi i PKDNj për rastet nr 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, par. 44 dhe 62 et seq.). Këto vështirësi, megjithatë, nuk duhet të shërbejnë për kamuflimin apo arsyetimin e dështimeve që nuk janë të lidhura në asnjë mënyrë kuptimplote me vështirësitë e cekura. Andaj, Paneli do të vlerësojë në çdo rast nëse ndonjë hap hetimor i caktuar që normalisht ka qenë i hapur për EULEX do të ishte bërë jopraktik nga arsye të ndërlidhura me rrethanat e pas konfliktit të pavarura prej atyre që kanë qenë duke bërë hetime (*L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 44).
56. Pritshmëritë e vëna mbi mundësinë e EULEX për hetimin dhe zgjidhjen e çështjeve penale të ndërlidhura duhet të jenë reale dhe të mos i vendoset EULEX barrë joproportionale të cilën mandati dhe burimet nuk mund t'i përmbushin (*L.O. kundër*

EULEX-it, 2014-32, vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 43 dhe 45, dhe referimet e tij në: vendimin e Panelit në *A,B,C,D kundër EULEX-it*, 2012-09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, para 50; *K deri T kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, par. 53; krahaso gjithashtu vendimin e PKDNj për rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 35; vendimi i PKDNj për rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, par. 70-71. Shih po ashtu *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, vendimi për pranueshmëri, 29 shtator 2015, par. 35-37; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, vendimi për pranueshmërinë, 30 shtator 2015, par. 72-74; shih po ashtu vendimin e PKDNj për rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, par. 70-71). Në secilin rast, prej Panelit pritet që të shqyrtojë nëse ka pasur pengesa konkrete dhe të vërteta të cilat mund të kenë sfiduar kapacitetet e EULEX për kryerjen e hetimeve të shpejta dhe efektive të ndonjë rasti. Ky vlerësim nuk ka për qëllim arsyetimin e mangësive operacionale që nuk janë të ndërlidhura me sfidat konkrete dhe të demonstrueshme. Shih, prapë, *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 44.

57. Në çdo rast, dhe në veçanti në raste të kësaj rëndësie, autoritetet hetimore priten që të veprojnë me zell dhe shpejtësi të arsyeshme dhe të investojnë burime proporcionale me nevojën dhe mundësinë e zgjidhjes së rastit. Ndonëse prej asnjë autoriteti hetimor nuk mund të pritet që t'i zgjidhë të gjitha rastet që paraqiten para tij, nga ai është e pritur që të veprohet me zell, shpejtësi dhe efektivitet të atillë për pasqyrimin e peshës së rastit që është nën hetim (*L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 46 dhe 59, dhe referimet e tyre në GjEDNJ: *Varnava dhe të tjerët v. Turqi*, Kërkesa nr. 16064/90 et al, Aktgjykimi i datës 18 shtator 2009, par. 191; *Palić v. Bosnja dhe Hercegovina*, Kërkesa nr. 4704/04, Aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, par.63). Zotimi dhe përkushtimi për këto standarde është në veçanti i rëndësishëm për një mision të sundimit të ligjit që ka për qëllim të shërbejë si shembull i zotimit të shoqërisë për dhënien fund të mosndëshkueshmërisë dhe ndërtimit të frymës së llogaridhënies për shkeljet e rënda të drejtave. Çfarëdo standardi që nuk është sipas atij standardi do të rrezikonte krijimin e një fryme të pajtimit me mosndëkueshmërinë dhe moskonsideratën për kërkimin e drejtësisë dhe llogaridhënies nga ana e viktimave (*L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 46 dhe referimet e tij në GjEDNJ: *Varnava dhe të tjerët v. Turqia*, kërkesa nr. 16064/90 et al, aktgjykimi i datës 18 shtator 2009, par. 191; *Palić v. Bosnja dhe Hercegovina*, kërkesa nr. 4704/04, aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, para 63); vendimi i PKDNJ për rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 80.”); *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016, par. 37; shih po ashtu vendimin e PKDNj për rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më sipër, par. 80).
58. Po ashtu duhet të theksohet për qëllimet aktuale se të drejtat temë e kësaj ankese janë në mesin e të drejtave themelore më të rëndësishmet. Ato prekin mbi interesat themelore të viktimave të pretenduara dhe duhet të garantohen në të gjitha rrethanat. Praktika e zhdukjeve të detyruara përbën shkelje të rëndë të këtyre të drejtave. Kjo pasqyrohet, *inter alia*, tek fakti se ajo tani konsiderohet dhe karakterizohet si krim kundër njerëzimit, në veçanti, në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale (Statuti i Romës, neni 7(1)(i)) dhe Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (Ligji nr. 05/L-053) (neni 13(1)(i)). Shih po ashtu Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet e detyruara, preambula dhe neni 5.
59. Të gjitha konsiderimet e përkufizuara më sipër janë marrë parasysh me rastin e vendimit për pranueshmërinë e rastit aktual dhe do të konsiderohen më tej në lidhje me meritën e rastit, aty ku është relevante.

Lidhja e mjaftueshme e përkohshme me veprimet themelore – kompetenca ratione temporis e Panelit dhe rregulli i gjashtë muajve

60. Misioni nuk ka ngritur asnjë problem rreth kësaj çështje dhe Paneli është i bindur se ai është kompetent *ratione temporis* dhe se rregulli i gjashtë muajve sipas Rregullit 25(3) të Rregullores së punës është respektuar. Shih edhe *Gashi v EULEX*, 2013-22, 7 prill 2014, par. 10; *Thaqi v EULEX*, cituar më sipër, par. 51).

Kompetenca ratione materiae e Panelit

61. Misioni nuk e ka kundërshtuar zyrtarisht kompetencën e Panelit *ratione materiae* për këtë rast dhe Paneli është me të vërtetë i bindur se ai është kompetent. Kjo çështje tashmë është adresuar në plotësi në raste materialisht të krahasueshme. Shih, p.sh., *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për pranueshmerinë, 30 shtator 2015; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi për pranueshmerinë, 29 shtator 2015; *Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për pranueshmerinë, 30 shtator 2015; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015.
62. Përveç kësaj, Paneli thekson se këto vepra mund gjithashtu të cilësohen si krime lufte, krime kundër njerëzimit apo krime me bazë etnike për të cilat Misioni ka pasur kompetenca specifike dhe shprehimore juridiksionale. Shih, në përgjithësi, nenin 3 (d) të veprimit të përbashkët të Këshillit. Shih po ashtu *Sadiku-Syla kundër EULEX-it-it*, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 44-46. Në rastin *D.W. et al*, Paneli theksoi si në vijim:

‘ka ekzistuar mundësi shumë e madhe se ato krime dhe shkeljet pasuese të të drejtave janë bazuar në konsiderime etnike apo fetare, çka qon më tej në territorin juridiksional mbi të cilin Misioni ka kompetencë. Në një mjedis pas konflikti ku raportet etnike dhe fetare ende mund të jenë të tensionuara dhe të thyeshme, raste të tilla janë prioritete të qarta hetimore. Kjo, prapë, nuk duket prej të dhënave se është konsideruar relevante për përcaktimin e Misionit të “rrethanave të jashtëzakonshme”.’

D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., dhe I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, 19 tetor 2016, par. 83 et seq, në veçanti par. 85.

63. Paneli po ashtu duhet të ritheksojë se hetimi i këtyre rasteve jo vetëm që ka përbë pjesë të mandatit të Misionit, ai po ashtu ka qenë element thelbësor dhe esencial i tij. Në *L.O. kundër EULEX-it*, Paneli ka theksuar se ‘mund të ketë pak pohime se hetimi i fatit të të zhdukurve – pavarësisht përkatësisë fetare apo etnike – duhet të jetë dhe të vazhdojë të jetë prioritet operacional për EULEX-in si Mision i sundimit të ligjit për çka atij duhet t’i sigurohen burime adekuate’ (*L.O. kundër EULEX-it*, rasti nr. 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 47).
64. Bazuar në të lartcekurat, Paneli është i bindur se çështja deri më 14 qershor 2018 ka qenë në kuadër të kompetencës së Misionit gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv dhe se Paneli është kompetent për të vendosur mbi meritën e ankesës – në lidhje me nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
65. Tani kthehet tek ajo çështje.

VII. VLERËSIMI I PANELIT LIDHUR ME MERITËN E RASTIT

Ky rast nuk është hetuar asnjëherë

66. Misioni ka pranuar në mënyrë efektive se nuk ka bërë hetime për këtë rast.
67. Po ashtu është e qartë edhe nga të dhënat se nuk janë bërë hetime efektive të rastit para se ai të ishte dorëzuar tek Misioni. Hapat e ndërmarrë, të shpjeguar më sipër, nuk mund të konsiderohen për qëllimin aktual si hetime efektive konsistente me mbrojtjen e të drejtave të ankuesit.
68. Paneli dëshiron të nënvizojë faktin se të drejtat e prekura në rastet si në atë aktual janë në mesin e të drejtave themelore të njeriut më të rëndësishmet. Në veçanti, këto raste shpesh përfshijnë çështje që u përkasin të drejtës për jetë, të drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimit mizor apo çnjerëzor, të drejtës për të vërtetën, të drejtës për respektimin e jetës familjare, dhe të drejtës për qasje në drejtësi. (*Milijana Avramović kundër EULEX-it*, vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-17, 4 qershor 2019, para 34). Natyra dhe shtrirja e masave që duhet të miratohen nga autoritetet kompetente për garantimin e mbrojtjes efektive të këtyre të drejtave duhet të jenë proporcionale dhe të maten kundrejt rëndësisë që i takon këtyre të drejtave dhe interesave bazë të cilat ato kërkojnë t'i mbrojnë (*Milijana Avramović kundër EULEX-it*, vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-17, 4 qershor 2019, para 34). Njëkohësisht, këto standarde duhet të vlejnjë për këtë Mision në mënyrë reale që merr parasysh, në veçanti, faktin se Misioni EULEX nuk është shtet, se burimet e tij kanë qenë të kufizuara, dhe se ai ka punuar në kohën përkatëse në mjedis të ndërlikuar pas konflikti. Shih, prapë *Milijana Avramović kundër EULEX-it*, vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-17, 4 qershor 2019, paragraf 36ff (dhe referencat e cituara aty); *A,B,C,D kundër EULEX-it*, 2012-09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, par. 50.
69. Në çdo rast, megjithatë, ku ka pretendime të besueshme se nenet 2 dhe 3 janë shkelur, prej autoriteteve pritet t'i hetojnë ato pretendime me qëllim të përcaktimit të së vërtetës dhe, nëse provat e mundësojnë, t'i sjellin përgjegjësit e atyre shkeljeve para drejtësisë. Shih, p.sh., *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016, par. 36; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, vendimi për pranueshmerinë, 30 shtator 2015, par. 88; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, vendimi për pranueshmerinë, 29 shtator 2015, par. 58. Shih po ashtu GjEDNj: *Nachova dhe të tjerët v Bullgaria*, kërkesat nr. 43577/98 dhe 43579/98, Aktgjykimi i datës 6 korrik 2005, par. 110; *Hugh Jordan v. Mbretëria e Bashkuar*, Kërkesa nr. 24746/94, aktgjykimi i datës 4 maj 2001, par. 105; *McCann dhe të tjerët v. Mbretëria e Bashkuar*, Aktgjykimi i datës 27 shtator 1995, seria A nr. 324, par. 161; *Assenov dhe të tjerët v. Bullgaria*, Aktgjykimi i datës 28 tetor 1998, raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1998-VIII, par. 102).
70. Në atë kuptim, e drejta e ankuesit – sipas nenit 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut – për hetimin e zhdukjes së xhaxhait të tij është shkelur. Pyetja tani është për përgjegjësinë e Misionit, nëse ka pasur ndonjë, për atë çështje.

Obligimet e Misionit për të drejtat e njeriut

71. Misionit i është kërkuar që të përmbushë përgjegjësitë e tij ekzekutive në një mënyrë që është konsistente me standardet relevante për të drejtat e njeriut. Kjo, ndër të tjera, ka nënkuptuar se ai do të hetonte rastet në kuadër të kompetencës së tij *juridiksionale* që ka përfshirë shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti aktual, si dhe rastet e tjera të zhdukjeve të detyruara/personave të zhdukur, kanë qenë pjesë mu e fushëveprimit të atyre kompetencave dhe përgjegjësi. Shih, p.sh., *Milorad Trifunović kundër EULEX-it*, 2016-

09, 11 dhjetor 2019, par. 63; *Dragiša Kostić kundër EULEX-it*, 2016-10, 13 shkurt 2020, par. 59; *Milan Ađančić kundër EULEX-it*, 2016-14, 11 dhjetor 2019, par. 63; *S.H. kundër EULEX-it*, 2016-28, 11 shtator 2019, par. 83.

72. Me qëllim të shpjegimit të mos hetimit të rastit në fjalë, Misioni në thelb i ngritë dy faktorë apo konsiderime:

- a) Sfida për hetimin e rasteve të këtij lloji në rrethanat e veçanta në të cilat Misioni është dashur të punojë; dhe
- b) Fakti se nga ai nuk mund të pritej t'i zgjidhë të gjitha rastet përkatëse pas parasysh shtrirjen e angazhimit, në veçanti duke pas parasysh organizimin dhe klasifikimin joadekuat të dosjeve të rasteve nga paraardhësi i tij, UNMIK, dhe marrëveshjen e UNMIK-EULEX për transferimin e rasteve, përkufizuar më poshtë.

73. Përveç kësaj, Misioni ngritë një sërë kundërshtimesh preliminare apo argumente juridike të cilat do të adresohen në vijim.

Rastet 'e hapura' dhe 'të mbyllura' të UNMIK

74. Misioni sugjeron se ky rast ka qenë i karakterizuar si 'i mbyllur' nga UNMIK, nuk ka qenë e paarsyeshme për Misionin që ta trajtojë atë si detyësor apo si të mos kërkojë prej tij ta hetojë rastin. Paneli nuk pajtohet dhe e refuzon atë sugjerim.

75. Karakterizimi nga UNMIK i ndonjë rasti si 'i mbyllur' ka qenë pa efekt juridik mbi Misionin. Me fjalë të tjera, Misionit nuk i është kërkuar më pak që t'i përmbushë përgjegjësitë e tij për të drejtat e njeriut në lidhje me ndonjë rast 'të hapur' të UNMIK siç ishte në lidhje me ndonjë rast 'të mbyllur' të UNMIK.

76. Më tej, prej shqyrtimit të atyre regjistrave Misioni e ka ditur se (a) ato nuk kanë qenë domosdoshmërisht të besueshme dhe (b) se rastet nganjëherë janë 'mbyllur' nga UNMIK në bazë të asaj se mbetjet e viktimave ishin gjetur. Siç e ka ditur Misioni, ky faktor nuk i ka dhënë fund obligimeve të tij për të drejtat e njeriut për hetimin dhe, nëse e mundësojnë provat, për sjelljen e përgjegjësve para gjyqit. Edhe nëse trupi i viktimës është gjetur, gjë që tek ky rast nuk ka ndodhur, gjetja e trupit të ndonjë personi nuk do t'i kishte dhënë fund obligimit detyrues të ndonjë shteti – ose, në këtë rast, një Misioni i sundimit të ligjit – për hetimin dhe përpjekjet për zgjidhjen e rastit. Shih, p.sh., *Q.J. kundër EULEX-it*, 2016-23, vendimi dhe gjetjet, 11 dhjetor 2020, par. 39-41. Siç është theksuar në raste të mëparshme, ky obligim – obligim i mjeteve – kërkon që autoritetet të miratojnë të gjitha masat e arsyeshme dhe të nevojshme si për vërtetimin e asaj që ka ndodhur me individin (individët) përkatës dhe, në rastet e kryerjes së ndonjë krimi, ashtu edhe për sjelljen e përgjegjësve para drejtësisë. Shih, *supra*, paragraf 55-58.

77. Në atë kontekst, klasifikimi i rasteve nga UNMIK si të hapura/të mbyllura nuk ka pasur qëndrim normativ mbi obligimet vetanake të Misionit. EULEX-i Kosovë ka qenë, ashtu siç është kërkuar me mandatin e tij, i obliguar që të hetojë çdo rast dhe të dedikojë kohën dhe burimet e nevojshme për t'u përpjekur për t'i zgjidhur ato raste dhe për t'i sjellë përgjegjësit para drejtësisë. Këtë Misioni ka dështuar ta bëjë. Shih, p.sh., *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 65; *Milorad Trifunović kundër EULEX-it*, 2016-09, 11 dhjetor 2019, par. 96; *Dragiša Kostić kundër EULEX-it*, 2016-10, 13 shkurt 2020, par. 88; *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, 12 shkurt 2020, par. 111; *Miomir Krivaković kundër EULEX-it*, 2016-13, 12 shkurt 2020, par. 108; *Milan Ađančić kundër EULEX-it*, 2016-14, 11 dhjetor 2019, par. 96; *Milijana Avramović kundër EULEX-it*, 2016-17, 4 qershor 2020, par. 54; *S.H. kundër EULEX-it*, 2016-28, 11 shtator 2019, par. 83, *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 99.

78. Rasti në fjalë thekson edhe një fakt tjetër në lidhje me klasifikimin e rasteve nga UNMIK si 'të hapura' dhe 'të mbyllura': paqartësia dhe mosbesueshmëria e tij. Pas sugjerimit se rasti duhet të qëndrojë 'i hapur', ai disi është paraqitur si 'i mbyllur' në databazën që i është dhënë Misionit pa ndonjë regjistër se përse ka ndodhur ky ndryshim i qëndrimit. Shih, *supra*, parag 34-37. Kësaj hutie i është shtuar shënimi o paqartë në baza e të dhënave e 'personave të zhdukur' dhe 'të krimeve të luftës' që janë transferuar nga UNMIK – ku i pari nuk ka shënjuar statusin e këtij rasti dhe i dyti e ka shënjuar atë si 'të mbyllur'. Këto kontradiktive është dashur ta alarmonin Misionin për besueshmërinë e kontestuar të këtij lloji të klasifikimit të rasteve si të hapur/të mbyllur dhe më tej ka theksuar nevojën që Misioni të bëjë vlerësimin e vet të rasteve.
79. Paneli kthehet tek konsiderimi i aspekteve specifike të këtij rasti që janë relevante për vlerësimin e veprimit të Misionit.

Transferimi i dosjeve nga UNMIK

80. Paneli ka theksuar në raste të mëparshme mënyrën joadekuate në të cilën UNMIK i ka mbajtur, organizuar dhe transferuar rastet dhe dosjet e rasteve tek Misioni. Paneli nuk do t'i përsërisë këto konstatime këtu, por thjeshtë thekson se veprimet e UNMIK padyshim se kanë pasur ndikim negativ mbi mundësinë e Misionit për t'i hetuar në mënyrë efektive dhe të shpejt rastet e zhdukjeve të detyrueshme që janë ndërlidhur me konfliktin apo në periudhën menjëherë pas tij.
81. Siç u theksua më lartë, Misioni sugjeron se si pjesë e vlerësimit të veprimit të tij, Paneli duhet ta ketë parasysh faktin se marrëveshja UNMIK-EULEX rreth transferimit të dosjeve prokuroriale nuk ka paraparë transferin e dosjeve që kanë qenë të hudhra poshtë apo të ndërprera nga UNMIK, po vetëm të dosjeve prokuroriale 'aktive'. Megjithatë, *nëse është sadopak relevante*, ai fakt do të kishte pasur një peshë shumë të vogël. Kjo për shkak se: (a) nuk ka rëndësi nëse kjo është paraparë në marrëveshjen në fjalë por se transferi i atyre dosjeve *në të vërtetë* është bërë; dhe (b) dallimi semantik mes *transferimit* dhe *arkivimit* në çka Misioni kërkon ta tërheqë vëmendjen nuk ka qëndrim mbi detyrimet e tij për të drejtat e njeriut: duke e pasur këtë dosje në posedim, prej Misionit është pritur që të njoftojë me të dhe, siç mund të ndodhë, ta përdorë atë në mënyrë efektive për qëllime të hetimeve dhe sjelljen e përgjegjësve para drejtësisë.
82. Në çfarëdo rasti, me apo pa dosje të tilla, Misionit do t'i ishte kërkuar që t'i hetonte ato raste për të cilat ai ka pasur dijeni dhe të cilët kanë hyrë në kuadër të përgjegjësisë së tij juridiksionale. Përgjegjësitë e tij – në veçanti, nga pikëpamja e të drejtave të njeriut – janë përcaktuar pavarësisht marrëveshjeve me UNMIK rreth transferimit të rasteve dhe dosjeve të rasteve.
83. Misioni po ashtu pohon se prokurorët e EULEX asnjëherë nuk kanë qenë kompetent për hetimin e këtyre rasteve kur dosjet e rasteve nuk kanë shkuar tek ta në mënyrën zyrtare. Paneli nuk mund t'i pranojë këto parashtrime për së paku dy arsye. Arsyeja e parë është se është përgjegjësi e Misionit që të sigurojë që ai ta organizojë veten në atë mënyrë që të garantojë mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Paneli tashmë ka theksuar në raste të mëparshme se nga një mision si EULEX është e pritshme që t'i organizojë regjistrat e vet si dhe transferin në atë mënyrë që ai të jetë në gjendje të garantojë në të gjitha rrethanat mbrojtjen efektive të të drejtave të atyre që janë pjesë e atyre dosjeve (*Becić kundër EULEX-it*, 2013-03, 12 nëntor 2014, par. 58–60).
84. Arsyeja e dytë është se mbrojtja efektive e atyre të drejtave nuk mund të varen prej marrëveshjeve specifike të bëra nga UNMIK dhe EULEX për transferin e dosjeve të rasteve. Misioni është informuar në mënyrë të duhur nga ankuesit për praninë e një numri

të madh të rasteve të zhdukjeve të detyruara. Nga pikëpamja e të drejtës për të drejtat e njeriut, përgjegjësia e Misionit për hetimin e atyre rasteve nuk është varur dhe nuk ka mund të varen prej parashtrimit zyrtar i një dosje të rastit “të drejtpërdrejtë” nga UNMIK. Ka qenë përgjegjësi e EULEX që t’i shqyrtojë në mënyrë efektive dhe t’i hetojë ato raste kur ato i janë sjellë.

85. Andaj, Paneli i hedhë poshtë pretendimet e Misionit për atë pikë.

Ndërlidhja me luftën

86. Një prej arsyeve të mospërmbushjes së obligimeve për të drejtat e njeriut në lidhje me këtë rast është po ashtu e dukshme nga ajo që Misioni ka theksuar në parashtrimet e tij. Siç është theksuar më sipër, Misioni ka përmendur se:

‘Nga një shqyrtim i regjistrave të EULEX, del se kurdo që prokurorët e EULEX kanë hasur në ndonjë dosje të rastit që i ka përkitur veprave penale të pretenduara (përfshirë vrasje dhe rrëmbime) të cilat kanë ndodhur pas 21 qershorit 1999, ata e kanë konsideruar veten jokompetentë dhe rastet i kanë përcjellë tek prokuroritë e qarkut përkatëse.’

87. Ai vlerësim, nëse me të vërtetë i miratuar nga prokurorët e EULEX, ka qenë i pasaktë për nga aspekti juridik. Misioni nuk i është referuar asnjë indikacioni normativ që do të sugjeronte se kompetenca e tij për rastet e personave të zhdukur apo zhdukjeve të detyruara ka qenë e kufizuar për atë periudhë. Deri në masën që ai i ka kufizuar përpjekjet e veta për periudhën e luftës, Misioni lexoi mandatin e vet dhe obligimet e tij të ndërlidhura me të drejtat e njeriut më ngushtë sesa që është dashur. Më tej, në këtë rast specifik, nuk ka asnjë indikacion se dosja e këtij rasti është përcjellë tek prokuroritë e qarkut dhe si rezultat ai ka mbetur i pa hetuar.

Emërtimi juridik është jorelevant

88. Në parashtrimet e tij, Misioni po ashtu duket se sugjeron se nocioni juridik i ‘zhdukjes së detyruar; nuk është bërë pjesë shprehimore e mandatit të tij. Kjo është tërësisht jorelevante meqë ai ka qenë në kuadër të fushëveprimit të veprave penale të rënda – në veçanti atyre me ngjyrë ‘etnike’ apo fetare – për të cilat ai ishte bërë përgjegjës.

89. Paneli dëshiron të theksojë se pyetja e zhdukjeve të detyruara, si shkelje e rëndë e të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe hetimi i tyre, ka përbërë pjesë integrale të obligimeve të Misionit për të drejtat e njeriut. Duke pasur parasysh funksionet ekzekutive të Misionit dhe mandatin e tij të përgjithshëm për të drejtat e njeriut, fushëveprimi i obligimeve për të drejtat e njeriut nuk ka mundur të kufizohet nga përdorimi i terminologjisë specifike apo kornizës.

90. Më tej, dhe ndryshe prej parashtrimeve të Misionit, aktet e zhdukjeve të detyruara mund të përbëjnë veprën e krimit të luftës. Ndonëse ligjet e luftës nuk parashohin ndonjë kategori juridike specifike të njohur si ‘zhdukje e detyruar’, këto ligje e penalizojnë çdo element që përbën një praktikë të tillë – nga ndalimi/burgimi arbitrar deri te vrasjet e paligjshme. Kjo shpjegon, për shembull, se këto akte janë ndjekur penalisht në Tribunalin Ndërkombëtar Penal për Ish-Jugosllavinë si krime lufte ndonëse nën emërtime të tjera juridike. Kjo gjithashtu e shpjegon se *Studimi i së drejtës zakonore të KNKQ (Rregulli 98)* përcakton se në lidhje me konfliktet e armatosura ndërkombëtare si dhe jo-ndërkombëtare:

Zhdukjet e detyruara janë të ndaluara.

91. Andaj, nuk ka pasur asgjë që e ka ndaluar Misionin nga hetimi i pretendimeve për zhdukjet me dhunë dhe ai nuk mund të fshihet prapa emërtimeve juridike për të shpjeguar dështimin e tij për përmbushjen e obligimeve të tij për të drejtat e njeriut në kontekstin e të cilave nocioni i 'zhdukjeve të detyruara' ka qenë i njohur mirë. Shih, p.sh., Konventën ndër-Amerikane për zhdukjet e detyruara të personave (1994); Asambleja e Përgjithshme e OKB, *Deklarata për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja e detyruar*, UN Doc A/RES/47/133, 18 dhjetor 1992 (më tej në tekst Deklarata e vitit 1992 për zhdukjet e detyruara), neni 1(1); Këshilli ekonomik dhe social i OKB, Raporti i grupit punues për zhdukjet e detyruara apo të pavullnetshme, UN Doc E/CN. 4/1996/38, 1 janar 1996; Komiteti i OKB për të drejtat e njeriut, *Komenti i përgjithshëm i CCPR nr. 6: neni 6 (e drejta për jetë)*, 30 prill 1982 (më tej në tekst Komenti i përgjithshëm nr. 6), s. 4; Asambleja e përgjithshme e OKB, personat e zhdukur, UN Doc A/RES/33/173, 20 dhjetor 1978 (më tej në tekst UN Doc A/RES/33/173); Asambleja e përgjithshme e OKB, Çështja e zhdukjeve të detyruara apo të pavullnetshme, UN Doc A/49/610/Add.2, 23 dhjetor 1994.
92. Andaj, nuk ka ekzistuar asnjë ndalesë normative për përmbushjen e obligimeve të Misionit për të drejtat e njeriut në lidhje me rastin aktual dhe raste të ngjashme.

Ndërlíkueshmëria dhe shkalla e sfidës hetimore

93. Paneli pastaj kthehet tek argumentet e Misionit lidhur me sfidat e hasura gjatë hetimit të rasteve të këtij lloji në kontekstin specifik të Kosovës gjatë periudhës së pas konfliktit.
94. Misioni me të drejtë ka nënvizuar disa prej sfidave të përfshira në hetimin e llojeve të rasteve që tani janë nën shqyrtim. Rastet e këtij lloji mund të jenë jashtëzakonisht të vështira për t'u hetuar, në veçanti kur shkalla e kriminalitetit relevant është e gjerë, burimet janë të kufizuara, dhe bashkëpunimi jo gjithherë i gatshëm. Dhe, në rastin e EULEX, nevoja për organizimin e dosjeve të rasteve që kanë qenë të menaxhuara dhe të organizuara keq nga misioni i OKB-së para se të transferoheshin.
95. Ndonëse ato sfida janë të vërteta, ato kanë qenë në proporcion me natyrën e përgjegjësive (dhe burimeve) që Misionit i janë caktuar. Misioni asnjëherë nuk ka pohuar publikisht se ka qenë e pamundur t'i kryejë përgjegjësitë e veta apo se ai nuk mund të vepronte në përputhje me obligimet e veta për të drejtat e njeriut. Nuk ekziston ndonjë informatë publike e Misionit me kërkesën për më shumë burime për t'ia mundësuar atij përmbushjen e atyre obligimeve apo sugjerimeve se ka qenë e pamundur të përmbushë mandatin e tij me burimet që i ishin caktuar. Përkundrazi, ai ka qëndruar i heshtur rreth asaj që ai tani thotë ka qenë pamundësia – për arsye praktike apo teknike – për t'u marrë me të gjitha rastet e transferuara. Vetëm kur shkeljet e të drejtave të ankuesve janë ngritur, Misioni i është drejtuar asaj rrethane si arsyetim për mosveprimin e tij dhe për dështimin për mbrojtjen e të drejtave të personave përkatës.
96. Misioni po ashtu duket se sugjeron se do të ishte e paarsyeshme të pritej prej tij që t'i hetonte të gjitha rastet e zhdukjeve dhe vrasjeve dhe t'i informonte të gjithë familjarët e personave përkatës.
97. Ajo, megjithatë, nuk është çështja relevante këtu. Çështja këtu është se përse ky rast specifik është lënë i paketuar dhe të afërmit e të zhdukurit të lënë në errësirë.
98. Më tej, kur Misioni dëshiron t'i drejtohet shkallës së sfidës si juridiksion për dështimin e tij, ai duhet të merr parasysh se çfarë proporcioni të atyre rasteve ai (a) i ka hetuar dhe (b) i ka zgjidhur. Kjo mund të ketë qenë relevante për adresimin e asaj nëse rasti në fjalë ka qenë dështim i jashtëzakonshëm apo rast që është pasqyrim i një modeli më të gjerë

të dështimeve për të vepruar. Prej rasteve që Paneli tashmë i ka trajtuar dhe prej informatave që i përkasin rastit në fjalë, është e qartë se ky i fundit është shpjegim më i besueshëm për dështimin e Misionit për hetimin e rastit në fjalë. Vetëm një pjesë e vogël e të gjitha rasteve të zhdukjeve të detyruara të ndërlidhura me konfliktin (apo me periudhën pas tij) i janë nënshtruar hetimeve efektive nga EULEX. Dhe një grup edhe më i vogël ka rezultuar me ndjekjen penale të të dyshuarve. *Kjo është informata mbi të cilën sjellja e Misionit për rastet individuale duhet të adresohet. Shkalla dhe vështirësia e detyrës, andaj, nuk mundet si e vetme të shpjegojë dështimin e Misionit për të hetuar rastin në fjalë.*

99. Në ato rrethana, Paneli nuk mund të pranojë si të arsyeshëm apo të besueshëm sugjerimin se shkalla e sfidës – ndonëse autentik për nga natyra – ofron arsyetim të vlefshëm për dështimin e Misionit për të hetuar rastin në fjalë dhe informimin adekuat të familjarëve të z. Kandić.

100. Paneli po ashtu dëshiron të theksojë si në vijim. Siç është theksuar më sipër (par.29), Raporti *ante mortem* i UNMIK për rastin sugjeron se

‘asnjë dëshmitar nuk ka mundur të identifikohet, ose për shkak se ata nuk kanë qenë duke jetuar në Kosovë ose për shkak se vendndodhjet e tyre nuk janë ditur’.

Ajo, megjithatë, nuk ka qenë arsyetim për dështimin për të hetuar. Përkundrazi, kjo është mu pika e një hetimi: të kërkohej, gjurmohen dhe intervistohen ata që mund të japin informata rreth rrethanave të kryerjes së krimit.

101. Andaj, Paneli gjen se për shkak të mos hetimit të këtij rasti, Misioni ka shkelur të drejtat e ankuesit të parapara me nenet 2 (kreu procedural) dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke i pasur parasysh ato gjetje, Paneli nuk ka nevojë të bëjë gjetje në aspektin e të drejtave të tjera të mbrojtura (në veçanti, ato që dalin nga nenet 8 dhe 13 të Konventës Evropiane).

Dështimi për informimin e familjarëve të të zhdukurit

102. Hetimi efektiv i rasteve të këtij lloji po ashtu kërkon që autoritetet t’i mbajnë viktimat në përgjithësi të informuar rreth procesit të hetimit. (*L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 61-63; *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, vendimi dhe gjetjet, 12 shkurt 2020, par. 97; *Milijana Avramović kundër EULEX-it*, vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-17, 4 qershor 2019, para 55; *S.H. kundër EULEX-it*, vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 66; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 60-61, 72-73; PShDNj, Shënimi i praktikës gjyqësore për obligimin për hetimin e pretendimeve të shkeljeve të të drejtave, fq. 28-30; shih po ashtu *Ahmet Özkan dhe të tjerët v. Turqia*, kërkesa nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 6 prill 2004, par. 311-314, *Isayeva v. Rusia*, kërkesa nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 24 shkurt 2005 par. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët v. Mbretëria e Bashkuar*, kërkesa nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 7 korrik 2011, par. 167). Ky kriter ka për qëllim të sigurojë që familjarët mund të kontribuojnë dhe marrin pjesë në mënyrë domethënëse dhe kërkon të zvogëlojë vuajtjet dhe dhimbjet nga mosdija e fatit të më të dashurve të tyre. (shih po ashtu *S.H. kundër EULEX-it*, vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66; *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, vendimi dhe gjetjet, 12 shkurt 2020, para 96).

103. Misioni nuk bën përpjekje të shpjegojë se përse ai ka dështuar të veprojë ashtu në këtë rast.

104. Kjo është pjesërisht e lidhur me faktin se ai nuk ka kryer hetime të këtij rasti andaj ka pasur pak apo aspak për të raportuar tek ata familjarë. Kjo, megjithatë, nuk është arsyetim për mosinformimin e familjarëve të personit të zhdukur. Kjo përkundrazi, për nga aspekti normativ, rëndon shkeljen e të drejtave të personave përkatës, në këtë rast ato të ankuesit.
105. Andaj Paneli gjen se Misioni gjithashtu nuk ka përmbushur obligimet e tij për informimin e familjarëve të personit të zhdukur përkatës në këtë rast dhe se ky dështim përbën shkelje të mëtejme të të drejtave themelore të ankuesit sipas neneve 2 (kreu procedural) dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
106. Duke i pasur parasysh gjetjet e sipërme, Paneli nuk do të bëjë gjetje rreth përputhshmërisë (apo ndryshe) të Misionit me garancitë e tjera relevante të të drejtave të njeriut.

Indikacioni i Misionit për gatishmërinë për të ndihmuar

107. Në fund, Misioni ka thënë se ai ishte i gatshëm që tu ndihmojë institucioneve të Kosovës për përpjekjet e tyre për gjetjen e z. Čedo Kandić dhe personat e tjerë të pagjetur nëse do të ketë prova të reja.
108. Megjithatë, duke e pasur parasysh se ai nuk ka bërë hetime dhe duhet të jetë në dijeni për mungesën e ndonjë hetimi të vazhdueshëm për këtë rast nga ana e autoriteteve të vendit, për Panelin nuk është e qartë se çka nënkupton kjo deklaratë për ankuesin. Në mungesë të hetimeve, është e pamundur që prova relevante të paraqiten, kështu që oferta e Misionit për ndihmë duket pak më shumë sesa mendim i dëshiruar.
109. Nëse, siç shpreson Paneli, Misioni dëshiron të ndihmojë për zgjidhjen e rastit aktual dhe rasteve të ngjashme, atij do t'i duhet të bëjë më shumë sesa të pres prej të tjerëve të kërkojnë ndihmën e tij dhe në fund, pas më shumë se një dekadë, të përgatisin një plan dhe masa konkrete me të cilat ai do të mund t'iu ndihmonte atyre që kanë përgjegjësi për hetimin e atyre rasteve.
110. Paneli po ashtu beson se Misioni duhet të konsiderojë në plotësi dhe me kujdes mënyrën e riparimit të dëmit për të cilin ai ka kontribuar sa i përket të drejtave të personave përkatës. Ndërsa një rregullim i tillë do të ishte i vonuar dhe ndoshta joadekuat, ai së paku do të demonstronte atë që Misioni nuk e ka demonstruar përgjatë dekadës së fundit, përkatësisht, se rastet e zhdukjeve të detyruara janë element i rëndësishëm i aktivitetit të tij. Fjalët nuk do të mjaftojnë. Veprimet – veprimet urgjente – janë ato që tani janë të nevojshme nëse Misioni dëshiron të bëjë rregullime.
111. Për atë arsye, Paneli do ta fton Shefin e Misionit që me kujdes të konsiderojë miratimin e një strategjie të plotë dhe efektive që Misioni më në fund ta bëjë çështjen e të zhdukurve prioritet të Misionit, përfshirë pranimin dhe sigurimin e rregullimeve efektive ku Misioni ka bërë shkelje të të drejtave të njeriut në rastet e zhdukjeve të detyruara.
112. Paneli thekson në këtë kontekst deklaratat publike që i atribuohen Shefit të Misionit ku ai ka dhënë indikacione se Misioni ka qenë dhe vazhdon të jetë i përkushtuar për të kontribuar për zgjidhjen e rasteve të zhdukjeve të detyruara (Shih, p.sh., Zyra për media e EULEX, komunikata për media: 'Ne kemi më shumë se 1640 arsye për të vazhduar punën tonë për përcaktimin e fatit të të pagjeturve,' thotë Shefi i Misionit të BE për Sundim të Ligjit me rastin e Ditës Kombëtare për Personat e Pagjetur'; Associated Press, 'Familjet kosovare kërkojnë përgjigje 21 vite pas konfliktit serb', 14 maj 2020: <https://apnews.com/d86d5397215c81f2f695f46d2c905977>).

113. Paneli sheh shpresa me kujdes tek kjo deklaratë dhe do ta ftone Shefin e Misionit që të jepte një indikacion për strategjinë që Misioni planifikon ta përgatisë në atë drejtim për të siguruar që të drejtat e njeriut të personave përkatës – përfshirë ankuesin në fjalë – janë duke u garantuar në mënyrë efektive në këtë kontekst.

Konkluzionet e Panelit lidhur me dështimin e Misionit për respektimin e obligimeve të tij për të drejtat e njeriut

114. Për arsyet e përkufizuara më sipër, Paneli gjen se Misioni i ka shkelur të drejtat themelore të ankuesit të garantuara, *inter alia*, me nenet 2 (kreu procedural) dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
115. Këto të drejta janë në mesin e të drejtave më të rëndësishme që garantoohen me Konventën Evropiane. Dhe shkeljet që i atribuohen Misionit janë të rënda dhe serioze. I përket garancive thelbësore dhe themelore të të drejtave të njeriut që Misioni është krijuar për t'i mbrojtur dhe mbështetur. Si ka dështuar të veprojë ashtu në lidhje me ankuesin dhe, si rezultat, i ka kontribuar situatës në të cilën ai vazhdon të jetojë. Situata në të cilën ai nuk ka informata rreth fatit të të zhdukurit, rrethanave në të cilat ai është zhdukur dhe se çka ka ndodhur me të.
116. Misioni duhet të merr një pjesë përgjegjësie për këtë situatë dhe duhet të gjejë ndonjë mënyrë për të gjetur ndonjë lloj lehtësimi për të.

Mandati aktual i Misionit dhe obligimet e tij për të drejtat e njeriut

117. Paneli ka ardhur tek formimi i pikëpamjes se mandati aktual i Misionit ose, së paku mënyra në të cilën ai është duke u interpretuar nga Misioni mund të mos jetë në gjendje të sigurojë që Misioni mund t'i rregullojë në mënyrë efektive të drejtat e viktimave siç është ankuesi në këtë rast.
118. Duke pasur parasysh se Shefi i Misionit vazhdimisht ja refuzuar të pranojë përgjegjësinë e Misionit për ato shkelje të cilat Paneli ia ka atribuar dhe duke pasur parasysh faktin se Misioni nuk mund të jap kompensime financiare, e as hetime për ato raste, kanë mbetur pak masa rregulluese për rregullimin e shkeljeve të Misionit.
119. Andaj, Paneli e fton Shefin e Misionit që me kujdes të konsiderojë se çfarë rregullimesh janë ende në dispozicion të Misionit në ndonjë rast si rasti aktual ku Misioni është gjetur të ketë shkelur të drejtat e ndonjë familjari të ndonjë personi të zhdukur dhe ta informojë Panelin për konkluzionet e tij.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

GJEN ankesën të pranueshme sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

GJEN se Misioni ka shkelur të drejtat themelore të ankuesit të garantuara me nenet 2 (kreu procedural) dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

PËRCAKTON se nuk është e nevojshme të bëhen gjetje edhe në lidhje me nenet 8 dhe 13 të Konventës;

GJEN MË TEJ se shkeljet janë të rënda dhe të vazhdueshme dhe se ato, prandaj, bëjnë thirrje për miratimin e masave rregulluese proporcionale me to;

E FTON SHEFIN E MISIONIT, në veçanti, të shqyrtojë interpretimin që aktualisht i është dhënë natyrës dhe fushëveprimit të obligimeve të Misionit për të drejtat e njeriut dhe të merr parasysh si në vijim:

1. Paneli i fton Shefin e Misionit që të konsiderojë që formalisht të pranojë shkeljen e të drejtave të ankuesit nga ana e Misionit dhe të ofrojë ndihmë adekuatë për shkeljen.
2. Paneli e fton Misionin që të vazhdojë të kërkojë, dhe të identifikojë prokurorinë përgjegjëse për hetimin e këtij rasti.
3. Paneli më tej e fton Misionin që të pyet prokurorin kompetent nëse çështja është duke u hetuar dhe, nëse nuk është duke u hetuar, përse.
4. Paneli e fton Misionin që të konsiderojë se çfarë hapa konkret, kuptimplote për familjarët e personit të zhdukur dhe Kosovën si tërësi, duhet të ndërmerren për të kontribuar në çuarjen përpara të hetimit të rasteve të personave që janë zhdukur në mënyrë të detyruar/personat e pagjetur. Paneli është i gatshëm të vazhdojë të angazhohet me shefin e Misionit në përpjekjet për gjetjen e zgjidhjeve për atë qëllim. Paneli dëshiron të theksojë, megjithatë, se hapat e ndërmarrë deri më tani nga Misioni janë joadekuate për nga pikëpamja e obligimeve të Misionit për të drejtat e njeriut dhe nuk kanë mundësi të kontribuojnë në mënyrë kuptimplote për zgjidhjen e këtyre rasteve. Tani është kohë kritike e Misionit që të bëjë më shumë për përmbushjen e obligimeve të tij për të drejtat e njeriut.
5. Paneli e fton Misionin që këtë vendim ta shpërndajë tek
 - i. Personeli përkatës brenda Misionit
 - ii. Zyrtarët relevantë të Bashkimit Evropian përgjegjës për Kosovën, rajonin e Ballkanit apo për çështje të të drejtave të njeriut.

PANELI ME RESPEKT I KËRKON MISIONIT që të raportojë pas zbatimit të këtyre rekomandimeve dhe të përgjigjet ndaj pyetjeve të tij sa më parë që e ka të mundur dhe jo më vonë se 28 shkurt 2021.

Për Panelin

Guénaël METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare

Anna AUTIO
Anëtare